



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 564 Prot

Tiranë më 29.07. 2015

V E N D I M

Nr. 75 Datë 29 / 07 / 2015

Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, gjatë procesit të rekrutimit, për pozicionet e punës *"Specialist në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit"*, Drejtoria e Ligjeve të BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian; *"Specialist në Sektorin për Programet në Fushën Ekonomike, Kohezionit Social dhe Bujqësisë"*, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian; *"Specialist në Sektorin e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transacional"*, në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transacionale në Ministrinë e Integrimit Evropian, *"Specialist në Sektorin për Programet e BE-së, në fushën e Demokracisë, Qeverisjes, Zbatimit të Ligjit dhe të të Drejtave Themelore"*, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian; *"Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin dhe Vlerësimin"*, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbikëqyr kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Nga monitorimi i i vazhdueshëm i faqes zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, në internet, në lidhje me plotësimin e pozicioneve të lira të punës në shërbimin civil, Komisioneri ka rënë në dijeni të faktit se janë shpallur për konkurim, disa pozicione pune, përkatësisht me numër rendor në listën e shpallur,

- 404 (1 pozicion) *"Specialist në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit"*, Drejtoria e Ligjeve të BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
- 402 (4 pozicione) *"Specialist në Sektorin për Programet në Fushën Ekonomike, Kohezionit Social dhe Bujqësisë"*, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
"Specialist në Sektorin e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transacional", në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transacionale në Ministrinë e Integrimit Evropian,
- 405(3 pozicione) *"Specialist në Sektorin për Programet e BE-së, në fushën e Demokracisë, Qeverisjes, Zbatimit të Ligjit dhe të të Drejtave Themelore"*, në Drejtorinë

e e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;

“Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin dhe Vlerësimin”, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;

“Specialist në Sektorin e e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transasional”, në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transacionale, në Ministrinë e Integrimit Evropian.

Duke u nisur nga rëndësia që kanë këto pozicione në sistemin e procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, si dhe për të siguruar transparencën e duhur të procesit të rekrutimit dhe standardet në lidhje me cilësinë e kandidatëve pjesëmarrës në konkurim, Komisioneri vlerëson se ky proces duhet të mbikëqyret në të gjitha fazat e zhvillimit të tij.

Për këtë arsye,

me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes, si dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me qëllim që të mbikëqyrë zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionet që përfshihen në këtë fushë, si dhe të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

VENDOSA:

1. Fillimin kryesisht të mbikëqyrjes tematike, në lidhje me procesin e rekrutimit, për pozicionet e punës të evidentuara në listën e shpallur nga Departamenti i Administratës Publike, me numër rendor:

- 404 (1 pozicion) *“Specialist në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit”*, Drejtoria e Ligjeve të BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
- 402 (4 pozicione) *“Specialist në Sektorin për Programet në Fushën Ekonomike, Kohezionit Social dhe Bujqësisë”*, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
“Specialist në Sektorin e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transacional”, në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transacionale në Ministrinë e Integrimit Evropian,
- 405(3 pozicione) *“Specialist në Sektorin për Programet e BE-së, në fushën e Demokracisë, Qeverisjes, Zbatimit të Ligjit dhe të të Drejtave Themelore”*, në Drejtorinë e e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
“Specialist në Sektorin për Asistencën e BE-së, Monitorimin dhe Vlerësimin”, në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Asistencës së BE-së, në Ministrinë e Integrimit Evropian;
“Specialist në Sektorin e e Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Transasional”, në Drejtorinë e Programeve Ndërkufitare dhe Transacionale, në Ministrinë e Integrimit Evropian.

2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

- **Altin Shumeli** Inspektor i mbikëqyrjes
Përgjegjës grupi
- **Matilda Idrizaj** Inspektor i Hetimit Administrativ
(Anëtar)
- **Ledina Zhupa** Inspektor i mbikëqyrjes
(Anëtar)
- **Atalvin Niço** Inspektor i Hetimit Administrativ
(Anëtar)
- **Saimir Muçmataj** Inspektor i mbikëqyrjes
(Anëtar)

3. Mbikëqyrja që do të zhvillohet për të gjitha fazat e procesit të rekrutimit, do të fillojë në datën **30.07.2015** dhe do të përfundojë në datën **20.08.2015**, sipas programit të mbikëqyrjes që do të jetë pjesë e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes, në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tirana, Shqipëri

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 564/2 Prot.

Tiranë, 29 . 07 . 2015

MIRATOHET

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM MBIKËQYRJE

(Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil)

1. Subjektet e mbikëqyrjes: **Departamenti i Administratës Publike**

2. Objekti i mbikëqyrjes: Mbikëqyrje tematike në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit të rekrutimit, për pozicionet e punës:

- “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe donatorëve të tjerë”, në Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe Projekteve, në ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave;
- “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve IPA dhe koordinimit me donatorët”, në Drejtorinë e Integritimit Evropian dhe Projekteve, në Drejtorinë e Përgjithëshme të Planifikimit Strategjik dhe Integritimit, në Ministrinë e Punëve të Brendëshme;
- “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Fondeve IPA dhe donatorëve të tjerë”, në Drejtorinë e Integritimit dhe Projekteve në Drejtorinë e Përgjithëshme të Jetësimit të Prioriteteve të Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Integritimit, në Ministrinë e Drejtësisë;
- “Drejtor i Drejtorisë së Integritimit Evropian dhe Programit IPA”, në Ministrinë e Financave;
- “Drejtor në Drejtorinë e Integritimit Evropian”, në Ministrinë e Punëve të Brendëshme.

3. Baza ligjore: Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

Ligji nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

4. Periudha e mbikëqyrjes: Mbikëqyrja do të përfshijë veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të

ngarkuara me ligj, si pjesmarrës në proceset e rekrutimit, sipas objektit të mbikëqyrjes.

5. Afati i mbikëqyrjes:

Mbikqyrja do të fillojë në institucion në datën **29.07.2015** dhe do të përfundojë brenda datës **15.08.2015**.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahet proces-verbal administrativ dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

1. Altin Shumeli Inspektor i mbikëqyrjes
(Përgjegjës grupi),

3. Matilda Idrizaj Inspektor për hetimin
administrativ
(Anëtar)

8. Dokumentimi i rezultateve të mbikëqyrjes:

Në përfundim të procesit të këqyrjes dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm do të përgatitet projekt-raporti i mbikëqyrjes, me të cilin do të njihen personat përgjegjës për t'i dhënë atyre mundësinë e sqarimeve dhe të paraqitjes së observacioneve. Më pas do të hartohet raporti përfundimtar i mbikëqyrjes i cili do t'i dërgohet institucionit, i shoqëruar me rekomandimet dhe paralajmërimet përkatëse për të rregulluar ligjshmërinë.

DREJTIMET E MBIKËQYRJES

1. Respektimi i kërkesave ligjore gjatë procesit të rekrutimit për pozicionet e punës objekt mbikëqyrje, në të gjitha fazat e tij duke përfshirë:

- Shpalljen e pozicionit të punës;
- Pranimin e dokumentacionit;
- Verifikimin paraprak të dokumentacionit;
- Respektimi i afateve të ankimit dhe kqyrja e dokumentacionit që materializon korrespondencën me pjesmarrësit;
- Procedurën e krijimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Pranimi;
- Testimi me shkrim;
- Intervista me gojë;
- Dokumentacioni që materializon përfundimin e fazës së vlerësimit;
- Njoftimet që kanë lidhje me rezultatet paraprake;
- Të gjitha veprimet e tjera administrative dhe aktet administrative që kanë lidhje me procesin objekt mbikëqyrjeje, gjatë zhvillimit të tij.

2. Probleme të ndryshme që mund të lindin gjatë procesit dhe që kanë lidhje me punën e njësisë përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në këtë proces rekrutimi.

Aneks i programit.

Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.

Në vijim të programit të mbikëqyrjes, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për të përfunduar këtë proces.

1. Dokumentacioni që provon procedurën e shpalljes së pozicionit të punës;
2. Pwrshkrimi i punws pwr pozicionet e shpallura;
3. Akti administrativ i krijimit të Komisionit të Përhershëm të Rekrutimit;
4. Dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët për të marrë pjesë në këto konkurime;
5. Dokumentacioni që materializon korespondencën me kandidatët pas verifikimit paraprak të dokumentacionit;
6. Gjithë dokumentacioni që do të krijohet në vjim të procesit dhe që ka lidhje me rekrutimet object mbikëqyrje;
7. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

DREJTORIA E MBIKËQYRJES

Arbana BASHA

DREJTOR